

SERVITUTET SENDORE DHE SERVITUTET PERSONALE DHE APLIKUESHMËRIA E TYRE NË KOSOVË

Abstrakt

Servitutet janë të drejta sendore në sendin e huaj në bazë të të cilave, të autorizuarit i lejohej shfrytëzimi i caktuarit i sendit të huaj.

Servitutet tradicionalisht ndahen në servitute sendore dhe servitute personale.

Sipas të drejtës së Kosovës servituti sendor është e drejta e pronarit përkatës të një paluajtshmërie (paluajtshmëria dominuese) që një paluajtshmëri tjetër (paluajtshmëria shërbyese) në një mënyrë të caktuar ta shfrytëzojë apo të ndaloj kryerjen e veprimi të caktuar ose të përjashtoj ushtrimin e së drejtës së caktuar, të cila rrjedhin nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë shërbyese, ndërsa servituti personal është e drejta e një personi në favor të të cilit është ngarkuar një paluajtshmëri që ta përdorë në një mënyrë të caktuar ose të ndaloj ushtrimin e veprime të caktuara apo të përjashtoj ushtrimin e një të drejte, e cila rrjedh nga pronësia në paluajtshmëri.

Karakteristikat kryesore të servituteve janë: Janë të drejta sendore; Janë të drejta sendore në sendin e huaj; Servitutet nuk mund të krijohen në servitut; Servitutet janë të papjesëtueshme etj.

Sipas Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore servitutet mund të krijohen në bazë të një pune juridike, një vendimi të organit shtetëror ose në bazë të ligjit.

Metodat e studimit: historike, normative, analitike, komperative.

Fjalët kyçe: Servituti, Sendi i Huaj, Paluajtshmëria, Pronësi, Lloje, Autorizim.